

UDHËZIM
Nr. 25, datë 18.11.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 30.10.2017, “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË PRINDËRVE”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 29/1, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në çdo pikë të udhëzimit nr. 24, datë 30.10.2017, “Për krijimin e Këshillit Kombëtar të Prindërve”, “Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR)” të zëvendësohet me “Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP)”.

2. Pika 4, e nenit ,8 ndryshon si më poshtë:

“4. Kryesia e Këshillit Kombëtar të Prindërve përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave, sipas niveleve (arsimi parashkollor dhe fillor, arsimi i mesëm i ulët dhe arsimi i mesëm i lartë)”.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, institucionet arsimore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini